


Informacione për deklaratën e dhënies së pëlqimit për analizën e potencialit

Shumë të nderuar prindër,

Për një të ardhme të sigurt profesionale të fëmijës suaj pas periudhës së shkollës, një orientim profesional i suksesshëm si dhe vendimi për zgjedhjen e profesionit në lidhje me të kanë rëndësi të veçantë. Ju si prindër jeni partneri më i rëndësishëm këtu, pasi ju mund t'i vlerësoni veçanërisht mirë interesat, potencialet dhe aftësitë e fëmijës suaj.

Në shkollat e Nordrain-Vestfalisë orientimi profesional, në kuadër të iniciativës së landit "Asnjë diplomë pa njohje - Kalimi nga shkolla në punë në NRW" (KAoA), është një pjesë përbërëse e qëndrueshme e mësimimit. Me pjesëmarrjen e ministrive, autoriteteve vendore, biznesit, sindikatave dhe Agjencisë Federale të Punësimit, është zhvilluar një proces sistematik orientues për çdo nxënës dhe çdo nxënës nga klasa 8 deri në kalimin nga shkolla në punë ose në universitet.



orientimit profesional dhe ofron bazën, për të njohur fushat e duhura profesionale në procese të tjera dhe për të kërkuar vendet e praktikës.

Analizat e potencialit kryhen nga institucione arsimore të certifikuara. Këtu përfshihen kompanitë e trajnimit që, ndër të tjera, mund të përdorin fondet publike për të kryer masat e përgatitjes profesionale. Ato janë shkruar sipas ligjit në fuqi të prokurimit publik. Përmbajtja dhe kriteret organizative përcaktohen në një përshkrim të shërbimit. Këto detyra i merr përsipër Agjencia Shtetërore e Promovimit të Tregtisë për Artizanatin në Nordrain-Vestfali, shoqatë e regjistruar (LGH).

Informacioni i thelluar për procedurën e analizës së potencialit të kryer në vend nga ofruesi përkatës do t'ju vihet në dispozicion nga shkolla në formën e një "përshkrimi të shkurtër" të organit përgjegjës dhe është pjesë e informacionit për dhënien e pëlqimit.

Analiza e potencialit zhvillohet jashtë shkollës, konsiderohet se është mësimdhënie në një formë tjetër (dekret i Ministrisë për Shkollat dhe Arsimin i datës 21.04.2020 për orientimin profesional) dhe si rregull kryhet në klasë.

Një pjesëmarrje në analizën e potencialit është vullnetare, kështu që marrin pjesë vetëm ato nxënës dhe ata nxënës, prindërit e të cilëve kanë nënshkruar deklaratën e bashkëngjitur të dhënies së pëlqimit për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale. Në rastin e një mospjesëmarrjeje për nxënëset dhe nxënësit nuk krijohet asnjë disavantazh shkollor.

Shkolla siguron një ofertë të orientimit profesional pa mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për nxënëset dhe nxënësit që nuk marrin pjesë. Këto nxënës dhe këta nxënës mund të marrin pjesë në elementet e tjera standarde, nëse ato/ata nuk janë të mbështetur nga ofruesi. Kjo përfshin njohjen e fushës profesionale që mbështetet nga ofruesi (BFE) dhe kursi i praktikës që mbështetet nga ofruesi (PK). BFE-të dhe PK-të operative janë të mundshme.

Për ecurinë e mëtejshme:

Ofruesit informojnë prindërit në një veprimtari informative në shkollë për faktin, se cili proces zbatohet në analizën e potencialit dhe se cilat të dhëna (vëzhgimi) mbledhen. Përveç kësaj, të gjithë prindërit - të pranishëm si dhe në mungesë - marrin këtë sqarim me shkrim dhe përshkrim të shkurtër të ofruesit për analizën e potencialit, për t'u informuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në këtë bazë për të vendosur rreth pjesëmarrjes së fëmijës së tyre.

Në ditën e analizës së potencialit nxënëset dhe nxënësit që marrin pjesë vëzhgohen nga eksperte dhe ekspertë në rastin e ushtrimeve të ndryshme. Te këto ushtrime bëhet fjalë për një përzierje të llojeve të ndryshme të detyrave të orientuara drejt veprimit (ushtrime ndërtimi, ushtrime bashkëpunimi, etj.) dhe formave sociale (detyra individuale, detyra ekipore dhe për partnerët, etj.) Një eksperte vëzhgon katër të rinj në të njëjtën kohë. Nga kjo gjë mbledhen të dhënat e vëzhgimit, se cilat derdhen në rezultatin e analizës së potencialit. Pas kryerjes së procesit të analizës së nxënësve dhe nxënësve i paraqitet një formular me Feedback, ku sigurohet që pyetësi të kryhet në mënyrë anonime.

Në raste individuale, punonjëset dhe punonjësit e zyrave të koordinimit komunal dhe bordit mbikëqyrës të shkollës kryejnë praktika me prova të rastësishme, të cilat i shërbejnë qëllimit të vetëm të sigurimit të cilësisë së analizës së potencialit dhe kontrollojnë vetëm zbatimin organizativ dhe të përmbajtjes në përputhje me rregullat. Kontrolli për respektimin e kriteve të ligjit të prokurimit dhe kontratave të përshkrimit të shërbimit në vend kryhet nga LGH, e cila gjithashtu kryen praktika me prova të rastësishme. Agjencia Federale e Punësimit në rolin e saj si ofruese e financave mund të marrë pjesë në një orë mësimi me prova të rastësishme. Gjithashtu, pas njoftimit paraprak stafi shoqëruar shkencor merr pjesë në një orë mësimi për qëllime vlerësimi në raste individuale. Është siguruar që të gjitha punonjëset dhe punonjësit e institucioneve të përmendura të mos shfaqin asnjë të dhënë personale të nxënësve dhe nxënësve. Për më tepër, ato/ata nuk mbajnë shënime për nxënëset dhe nxënësit individual.

Në rastet me nevojë të veçantë për kujdes mësuesit, në rastin e dhënies së pëlqimit të prindërve dhe në konsultim me ofruesin, mund të marrin pjesë për mbikëqyrjen në analizën e potencialit. Nëse është e nevojshme, ndihmëset dhe ndihmësit e integritetit të të rinjve që kanë nevojë për mbështetje të veçantë arsimore mund të jenë të pranishëm në analizën e potencialit.

Rezultatet e analizës së potencialit u dorëzohen nxënësve dhe nxënësve nga personeli i organit përgjegjës në një takim vlerësimi, në të cilin mundësisht janë të pranishëm edhe prindërit. Menjëherë pas takimit të vlerësimit ofruesi i fshin të gjitha të dhënat personale.



Prandaj, në rastin e humbjes së dokumenteve të dorëzuara, ato nuk mund të krijohen përsëri.

Listat e pjesëmarrësve (me të dhënat e mëposhtme: Mbiemri, emri, datëlindja, gjinia, paraqitja e deklaratës së dhënies së pëlqimit) përcillen më tej te LGH, atje përdoren vetëm për qëllime faturimi dhe asgjësohen pas pesë vjetësh.

Deklarata e nënshkruar e dhënies së pëlqimit ruhet për pesë vjet në shkollë dhe më pas asgjësohet. Dhënia e pëlqimit mund të revokohet në çdo kohë për të ardhmen, pa i krijuar disavantazhe ligjore fëmijës suaj. Në rastin e një revokimi të gjitha të dhënat personale fshihen menjëherë. Revokimi duhet t'i deklarohet shkollës, e cila ndërmjetëson zbatimin e revokimit tek organet e tjera, nëse kjo është e nevojshme.



Deklarata e dhënies së pëlqimit:

Unë jam në dijeni të informacioneve për deklaratën e dhënies së pëlqimit për analizën e potencialit dhe përshkrimit të shkurtër të ofruesit _____ për ecurinë e analizës së potencialit dhe jam dakord që fëmija im

Mbiemri, emri i nxënëses/nxënësit

klasa

të marrë pjesë sipas procedurës së përshkruar më sipër në analizën e potencialit dhe që në kuadër të kësaj procedure të përpunohen të dhënat e tij personale - siç përshkruhet në informacion.

Emri i prindërit

vendi, data nënshkrimi